UDHËZIM
Nr. 4, datë 15.2.2016

PËR PROCEDURAT NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 146/2015, DATË 17.12.2015, "PËR PUNËKËRKUESIT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 9, të nenit 4, të ligjit nr. 146/2015, datë 17.12.2015, "Për punëkërkuesit",

UDHËZOJ:

I. Regjistrimi i punëkërkuesit dhe statusi i tij në zyrën e punësimit

1. Çdo person, që jeton në Republikën e Shqipërisë dhe kërkon të regjistrohet si punëkërkues, të drejtohet në zyrën përkatëse të punësimit. Zyra përkatëse e punësimit regjistron si punëkërkues personin që:

a) Është në moshë pune;

b) Paraqitet personalisht me një dokument identifikimi;

c) Kërkon punë;

d) Është i aftë dhe i gatshëm për punë.

Personi, që deklaron se nuk është në marrëdhënie pune apo i vetëpunësuar, paraqet në zyrën e punësimit librezën e punës, nëse ka një të tillë.

2. Zyra përkatëse e punësimit planifikon një intervistë të plotë regjistrimi për vlerësimin e punësueshmërisë së punëkërkuesit, përcaktimin e profilit të tij, nevojën për shërbime dhe planin e veprimeve për punësim.

Në sistemin e shërbimeve të punësimit dhe në formularin standard për regjistrimin e punëkërkuesit regjistrohen të dhënat e identitetit të punëkërkuesit dhe informacioni për aftësitë, njohuritë, kompetencat, aktivitetin e kërkimit të punës, motivimin për punë dhe pritshmërinë për punësim në tregun aktual të punës.

Punëkërkuesi i regjistruar firmos formularin e regjistrimit për të konfirmuar vërtetësinë e deklarimit dhe për të lejuar zyrën e punësimit të përpunojë dhe përdorë të dhënat e deklaruara.

3. Personi i regjistruar mban statusin "Punëkërkues". Zyra përkatëse e punësimit vendos për dhënin e statusit "Punëkërkues i papunë" brenda një muaji kalendarik, nga data e paraqitjes së tij për intervistën e plotë të regjistrimit, pasi verifikon deklarimin e tij si punëkërkues dhe gjendjen e punësimit në regjistrin e organeve tatimore.

Dhënia e statusit "Punëkërkues i papunë" regjistrohet në sistemin e shërbimeve të punësimit dhe në formularin e punëkërkuesit. Punëkërkuesi, me këtë status në sistem, mund të verifikohet drejtpërdrejt nga institucionet e tjera, të lidhura me sistemin e shërbimeve të punësimit, apo nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al.

4. "Punëkërkues i papunë" përfiton shërbime punësimi dhe pjesëmarrje në programet aktive të punësimit, apo programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura, si më poshtë:

a) Informacion mbi vendet e lira të punës;

b) Ndërmjetësim për punësim;

c) Këshillim dhe orientim për karrierë, profesion dhe punësim, për:

i) zgjedhjen e një profesioni të përshtatshëm me cilësitë individuale të kërkuar në tregun e punës;

ii) identifikimin e aftësive të munguara dhe ofrimin e mjeteve të përshtatshme për plotësimin e tyre, si arsimimin ose formimin profesional;

iii) identifikimin e qëllimit të punësimit, qasjen në punësim, mundësitë e kualifikimeve, si dhe për të kuptuar aftësitë e nevojshme për të kërkuar e mbajtur një vend pune.

d) Formim profesional falas në qendrat publike të formimit profesional;

e) Pjesëmarrje në masat e nxitjes së punësimit;

f) Përfitim të pagesës së papunësisë;

g) Vërtetimin e papunësisë.

Pas përfitimit të statusit "Punëkërkues i papunë", ai pajiset nga zyra përkatëse e punësimit me "Kartelën e punëkërkuesit të papunë", sipas formatit unik të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

5. Zyra përkatëse e punësimit vërteton për institucionet e tjera të qenit i papunë vetëm për punëkërkuesin, që mban statusin "Punëkërkues i papunë", nëpërmjet:

a) Listave emërore me të dhënat e identitetit;

b) Lidhjes së drejtpërdrejtë të institucioneve në sistem;

c) Portalit unik qeveritar e-albania.al.

Punëkërkuesi i papunë mund ta vërtetojë këtë status edhe duke paraqitur pranë institucioneve të tjera kartelën e punëkërkuesit të papunë, të konsideruar të vlefshme në bazë të datës së fundit të paraqitjes, brenda afatit njëmujor, të konfirmuar me shënimet dhe identifikimin e specialistit dhe të vulosur nga institucioni.

Zyra e punësimit, për raste të veçanta, vërteton statusin e punëkërkuesit të papunë për institucionin, që e kërkon atë me anë të vërtetimit të lëshuar prej saj, sipas formatit tip të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

6. Në zyrën e punësimit mund të regjistrohet për të kërkuar punë ose një punë të re edhe personi, që deklaron se është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar.

Pas vlerësimit të punëkërkimit personi do të regjistrohet në sistem dhe në formularin përkatës me statusin "Punëkërkues". Personi me këtë status do të përfitojë shërbimet e punësimit për gjetjen e një pune të re apo përgatitje për punë, informacion për vendet e lira të punës, këshillim për punë e profesion dhe ndërmjetësim në punë.

I regjistruari si "Punëkërkues" nuk pajiset me kartelën e punëkërkuesit të papunë dhe nuk përfiton vërtetim nga zyra e punësimit me qëllim përfitimi nga programet shtetërore të mbësh-tetjes me të ardhura. Për këtë "Punëkërkues" nuk shfaqen të dhëna në sistemet e institucioneve të tjera, të lidhura me sistemin e shërbimeve të punësimit.

Ai nuk përfiton falas pjesëmarrjen në kurset e formimit profesional në qendrat publike dhe nuk mund të jetë pjesëmarrës në programet e nxitjes së punësimit për punëkërkuesit e papunë.

Si kërkues pune me status "Punëkërkues" mund të regjistrohen në zyrën e punësimit edhe studentët, që vazhdojnë studimet, të cilët u drejtohen zyrave të punësimit për të kërkuar një punë me kohë të pjesshme.

Në rast se, gjatë periudhës së regjistrimit, punëkërkuesi ndërpret marrëdhëniet e punës aktuale, pas verifikimit në regjistrin e organeve tatimore, zyra e punësimit vendos për dhënien e statusit të punëkërkuesit të papunë.

7. Kur punëkërkuesi paraqitet për të kërkuar punë në një zyrë tjetër punësimi nga ajo që ushtron veprimtarinë në zonën e vendbanimit të tij të përhershëm, i konfirmuar ky vendbanim edhe nga lidhja në sistem me regjistrin e gjendjes civile, zyra e punësimit verifikon regjistrimin si punëkërkues në bazën e të dhënave të sistemit të shërbimeve të punësimit.

- Nëse personi nuk rezulton i regjistruar, vazhdon procedurat e plota për vlerësim dhe regjistrim në zyrën ku është paraqitur.

- Nëse personi rezulton i regjistruar si punëkërkues, bën një rivlerësim të punësueshmërisë së tij, verifikon statusin e punësimit dhe kategorinë në të cilën është klasifikuar nga zyra përkatëse, që ka bërë regjistrimin.

Punëkërkuesi i regjistruar përfiton ose jo nga shërbimet e punësimit dhe programet që ofron zyra e punësimit, në varësi të statusit të tij në zyrë "Punëkërkues" apo "Punëkërkues i papunë".

8. "Punëkërkuesi i papunë" i regjistruar në zyrën tjetër të punësimit përfiton të gjitha shërbimet e punësimit dhe të përgatitjes për punë, formim profesional falas në qendrat publike të formimit dhe pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit, për të cilat aktet përkatëse nënligjore të programit nuk e kushtëzojnë përfshirjen në varësi të vendbanimit të përhershëm. Edhe për të përfituar pagesën e të ardhurave nga papunësia ai duhet të drejtohet në zyrën përkatëse ku ka vendbanimin e përhershëm.

Territori, që ka në juridiksion zyra përkatëse e punësimit, sipas ndarjes administrativo-territoriale të njësive administrative, paraqitet në shtojcën nr. 1 "Kompetencat territoriale të zyrës së punësimit", bashkëlidhur këtij udhëzimi. Shërbimi Kombëtar i Punësimit të bëjë përditësimet me këtë ndarje territoriale në sistemin e shërbimeve të punësimit.

9. Punëkërkuesi i papunë duhet të paraqitet në zyrën e punësimit çdo muaj ose sa herë që thirret pranë saj për ofrimin e një punësimi të përshtatshëm, për pjesëmarrje në programet nxitjes së punësimit apo të formimit profesional, për të cilat zyra e përzgjedh si kandidat të përshtatshëm. Në takimin e planifikuar punëkërkuesi duhet të deklarojë përpjekjet individuale për kërkimin e punës.

10. Për të gjithë punëkërkuesit e regjistruar, të paktën një herë në gjashtë muaj, bëhet një riintervistim për rishikimin e profilit, vlerësimin e punësueshmërisë së tyre dhe rishikimin e planeve individuale të punësimit.

11. Në çdo rast, që zyra e punësimit verifikon se informacioni i punëkërkuesit nuk është i vërtetë, e thërret për riintervistë dhe pas saj vendos për heqjen ose jo të statusit të punëkërkuesit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

II. Kategorizimi i punëkërkuesve të papunë

Punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrën e punësimit kategorizohen në tre nëngrupe.

1. "Punëkërkues, që përfitojnë ndihmë ekonomike"

Në këtë kategori klasifikohen punëkërkuesit, që kanë fituar statusin "Punëkërkues i papunë", pas procedurave standarde të vlerësimit dhe regjistrimit si të tillë në zyrën e punësimit, për të cilët njësia administrative konfirmon që ka miratuar mbështetjen e tyre me të ardhura nga ky program shtetëror. Konfirmimi merret me shkrim ose nëpërmjet sistemit, kur kjo mundësohet. Të dhënat plotësohen në sistem, në formularin e regjistrimit dhe në kartelën e punëkërkuesit të papunë.

Në fund të çdo muaji zyra e punësimit njofton me shkrim institucionin përgjegjës për punëkërkuesit e papunë, përfitues të ndihmës ekonomike, që çregjistrohen për arsye punësimi apo që u heq statusin, duke përshkruar arsyen përkatëse, me qëllim marrjen e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Verifikimi i statusit "Punëkërkuesi i papunë" nga njësia administrative, kur mundësohet bëhet nëpërmjet sistemit.

2. "Punëkërkues, që përfitojnë pagesë papunësie"

Në këtë kategori klasifikohen punëkërkuesit, që kanë fituar statusin "Punëkërkues i papunë", pas procedurave standarde të vlerësimit dhe regjistrimit si të tillë në zyrën e punësimit, për të cilët zyra e punësimit vendos të miratojë kërkesën për përfitimin e të ardhurës nga papunësia, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse. Gjatë periudhës së papunësisë, zyra i jep përparësi mundësive të punësimit, për rikthimin sa më shpejt në tregun e punës ose përfshirjes në programet aktive të punësimit e formimit profesional.

Në përfundim të periudhës së përfitimit, nëse punëkërkuesi nuk është punësuar, do të ndryshojë kategorinë në të cilën është klasifikuar për efekt të mbështetjes me të ardhura.

3. "Punëkërkues të tjerë"

Në këtë kategori klasifikohen të gjithë punëkërkuesit që kanë fituar statusin "Punëkër-kues i papunë", të cilët nuk përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura të përshkruara më sipër, dhe i drejtohen zyrës së punësimit për të marrë shërbime punësimi e përgatitje për punë, për t'u punësuar në një vend pune të përshtatshëm apo për të përfituar nga pjesëmarrja në programet aktive që ajo zbaton.

Në këtë kategori do të klasifikohen dhe punëkërkuesit, të cilët kanë si kusht përfitimi të qenit punëkërkuesi i papunë, i regjistruar në zyrën e punësimit, për të përfituar të ardhura nga programe të tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura, të miratuara me akte ligjore të veçanta.

III. Çregjistrimi i punëkërkuesit të papunë, heqja/refuzimi i statusit në zyrën e punësimit

1. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin "Punëkërkues i papunë" ose vendos të mos ia japë atë personit, që pretendon ta fitojë, nëse ai deklaron se nuk pranon të punësohet në një vend pune të paguar në përshtatje me:

a) Karakteristikat e tij individuale (moshën, gjininë, kushtet shëndetësore);

b) Kualifikimin dhe aftësitë e tij profesionale (arsimimin, formimin profesional, kohëzgjatjen e punësimit të mëparshëm, përvojën e fituar);

c) Vendbanimin dhe ndikimin e punës në fjalë në gjendjen personale dhe familjare.

Punëkërkuesi, që humb statusin, për arsye të mos pranimit të punësimit në një vend pune të përshtatshëm, çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen "Refuzon vendin e punës" dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

2. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin "Punëkërkues i papunë", ose vendos të mos ia japë atë personit, që pretendon ta fitojë, nëse ai deklaron në zyrën e punësimit, se nuk kërkon punë. Punëkërkuesi, që humb statusin për këtë arsye çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen "Nuk kërkon punë", dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

3. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin "Punëkërkues i papunë" punëkërkuesit, që deklaron se nuk pranon të marrë pjesë në një nga programet e nxitjes së punësimit apo programe të tjera të ofruara prej saj, për t'u punësuar apo mësuar një profesion të përshtatshëm, që e ndihmon atë për t'u integruar në tregun e punës.

Punëkërkuesi, që humb statusin për arsye të mos pjesëmarrjes në program, çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen "Refuzon pjesëmarrjen në program" dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

4. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin "Punëkërkues i papunë" punëkërkuesit, që deklaron se nuk pranon të aftësohet nëpërmjet formimit profesional të ofruar falas në qendrat publike të formimit

profesional, në rastin kur formimi vlerësohet i përshtatshëm në përputhje me karakteristikat e tij individuale dhe me kërkesat që ka tregu e punës.

Punëkërkuesi, që humb statusin për arsye të këtij mospranimi çaktivizohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, duke u çregjistruar me arsyen "Refuzon formimin profesional" dhe nuk shfaqet në sistemet e institucioneve të tjera të lidhura me të.

5. Zyra përkatëse e punësimit i heq statusin "Punëkërkues i papunë" edhe punëkërkuesit që nuk paraqitet në takimin e planifikuar në zyrën e punësimit, sipas afateve të përcaktuara në ligj apo kur i kërkohet një gjë e tillë.

Nëse punëkërkuesi nuk bën një njoftim paraprak për të arsyetuar mosparaqitjen në takimin e planifikuar dhe për të konfirmuar një datë tjetër takimi në adresat (të dhënat) e kontaktit, të vëna në dispozicion nga zyra për këtë qëllim dhe nuk e dokumenton mosparaqitjen në takimin më të afërt në zyrën e punësimit, ai humb statusin e punëkërkuesit të papunë dhe çregjistrohet me arsyen "Nuk u paraqit në zyrën e punësimit".

6. Rastet e tjera të çregjistrimit të punëkërkuesit të papunë dhe ndryshimit të statusit të tij janë ato kur:

a) Punëkërkuesi i papunë punësohet në një punë të përshtatshme me ndërmjetësimin e zyrës së punësimit dhe çregjistrohet me arsyen "Ndërmjetësim në punë";

b) Punëkërkuesi i papunë punësohet në një vend të lirë pune, të cilin e gjen vetë si rezultat i kërkimit individual gjatë periudhës, që merr shërbime punësimi në zyrën e punësimit, apo kur ai punësohet në një nga vendet e lira të shpallura në zyrën e punësimit, për të cilin merr informacion gjatë vizitave në zyrë apo në portalin *online* të shërbimeve të punësimit http://puna.gov.al/ ose në faqen zyrtare të SHKP http://www.shkp.gov.al/. Në këtë rast, ai çregjistrohet me arsyen "Ka gjetur punë vetë";

c) Punëkërkuesi i papunë punësohet nëpërmjet pjesëmarrës në një program të nxitjes së punësimit dhe çregjistrohet me arsyen "Pjesëmarrës në program nxitje punësimi".

7. Propozimi për punësim apo pjesëmarrjes në programe regjistrohet në sistemin e shërbimeve të punësimit dhe formularin përkatës. Për çdo rast mospranimi apo refuzimi punëkërkuesi nënshkruan deklaratën me arsyen përkatëse. Zyra e punësimit merr vendimin për heqjen/refuzimin ose jo të statusit të punëkër-kuesit të papunë, pasi shqyrton deklarimet përkatëse rast pas rasti.

Deklarata e nënshkruar i bashkëngjitet formularit të regjistrimit. Në rast të mos nënshkrimit të deklarimit nga punëkërkuesi, deklarata firmoset vetëm nga specialisti me shënimin "Punëkërkuesi refuzon të nënshkruajë".

Formati i deklaratës për konfirmimin e mospranimit të punësimit apo pjesëmarrjes në programe i bashkëngjitet këtij udhëzimit në shtojcën nr. 2.

8. Kur vendimi për heqjen e statusit të punëkërkuesit të papunë ankimohet nga punëkërkuesi, shqyrtimi dhe vendimmarrja bëhet nga një grup vlerësimi, i ngritur nga titullari i zyrës përkatëse të punësimit për këtë qëllim.

9. Personi, të cilit i refuzohet apo i hiqet statusi "Punëkërkuesi i papunë", ka të drejtë për të aplikuar për regjistrim në zyrën punësimit dhe për ta rifituar atë, vetëm pas një periudhe kohe tremujore.

Afati i llogaritjes së kësaj periudhe kohore do të bazohet mbi datën, në të cilën është bërë çregjistrimi i tij në sistem dhe në formularin përkatës të regjistrimit në zyrën e punësimit.

IV. Për ndjekjen dhe zbatimin e dispozitave të tjera ligjore

1. Zyra e punësimit informon Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe merr konfirmim prej tij për vendin e lirë të punës, të shpallur nga punëdhënësi në zyrën e punësimit, i cili refuzohet nga pjesa më e madhe e punëkërkuesve të përzgjedhur si kandidatë të përshtatshëm për t'u punësuar në të, me arsyen e kushteve të papërshtatshme të punës dhe pagesës, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Për zbatimin e afateve të paraqitjes të punëkërkuesve të papunë, për të cilët datat e paraqitjes në zyrën e punësimit dhe procedurat përkatëse janë përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 146/2015, datë 17.12.2015, "Për punëkërkuesit" dhe këtij udhëzimi, të vijojnë takimet në zyrën e punësimit, deri në datën më të fundit të planifikuar dhe të informohen për ndryshimet ligjore në vazhdim.

3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr rregulloren për procedurat që ndjek zyra e punësimit në zbatim të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi

SHTOJCA NR. 1
TERRITORI NË JURIDIKSION TË ZYRAVE TË PUNËSIMIT NË PËRPUTHJE ME NDARJEN E RE ADMINISTRATIVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2014, "PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Nr.	Zyra e punësimit	Njësitë e qeverisjes vendore
1.	**Qarku Berat**	**Bashkia**
	DRSHKP Berat	Berat
		Ura-Vajgurore
	ZVSHKP Kuçovë	Kuçovë
	ZVSHKP Skrapar	Skrapar
		Poliçan
2.	**Qarku Dibër**	**Bashkia**
	DRSHKP Dibër	Dibër
	ZVSHKP Bulqizë	Bulqizë
	ZVSHKP Mat	Mat
		Klos
3.	**Qarku Durrës**	**Bashkia**
	DRSHKP Durrës	Durrës
		Shijak
	ZVSHKP Krujë	Krujë
4.	**Qarku Elbasan**	**Bashkia**
	DRSHKP Elbasan	Elbasan
		Cërrik
		Belsh
	ZVSHKP Peqin	Peqin
	ZVSHKP Gramsh	Gramsh
	ZVSHKP Librazhd	Librazhd
		Përrenjas
5.	**Qarku Fier**	**Bashkia**
	DRSHKP Fier	Fier
		Patos
		Roskovec
	ZVSHKP Lushnje	Lushnjë
		Divjakë
	ZVSHKP Mallakastër	Mallakastër
6.	**Qarku Gjirokastër**	**Bashkia**
	DRSHKP Gjirokastër	Gjirokastër
		Libohovë
		Dropull
	ZVSHKP Tepelenë	Tepelenë
		Memaliaj
	ZVSHKP Përmet	Përmet

		Këlcyrë

Nr.	Zyra e punësimit	Njësitë e qeverisjes vendore
7.	**Qarku Korçë**	**Bashkia**
	DRSHKP Korçë	Korçë
		Maliq
		Pustec
	ZVSHKP Devoll	Devoll
	ZVSHKP Kolonjë	Kolonjë
	ZVSHKP Pogradec	Pogradec
8.	**Qarku Kukës**	**Bashkia**
	DRSHKP Kukës	Kukës
	ZVSHKP Has	Has
	ZVSHKP Tropojë	Tropojë
9.	**Qarku Lezhë**	**Bashkia**
	DRSHKP Lezhë	Lezhë
	ZVSHKP Mirditë	Mirditë
	ZVSHKP Kurbin	Kurbin
10.	**Qarku Shkodër**	**Bashkia**
	DRSHKP Shkodër	Shkodër
		Vau i Dejës
	ZVSHKP Malësi e Madhe	Malësi e Madhe
	ZVSHKP Pukë	Pukë
		Fushë-Arrëz
11.	**Qarku Tiranë**	**Bashkia**
	DRSHKP Tiranë	Tiranë
		Kamzë
		Vorë
	ZVSHKP Kavajë	Kavajë
		Rrogozhinë
12.	**Qarku Vlorë**	**Bashkia**
	DRSHKP Vlorë	Vlorë
		Selenicë
		Himarë
	ZVSHKP Delvinë	Delvinë
		Finiq
	ZVSHKP Sarandë	Sarandë
		Konispol

SHTOJCA NR. 2
FORMATI I DEKLARIMIT NË ZYRËN E PUNËSIMIT

SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

DREJTORIA RAJONALE/ ZYRA VENDORE E PUNËSIMIT

Z./znj._____

emër, atësi, mbiemër

Paraqitur në zyrën e punësimit më datë __. __.201__

Deklaron si më poshtë:

1. Nuk kërkon punë..... ☐
2. Refuzon vendin e punës ..... ☐

   Përshkrimi i vendit të punës.....

   .....
3. Refuzon pjesëmarrjen në programin e nxitjes së punësimit: ..... ☐

   Përshkrimi i programit të ofruar (VKM/profesioni/ndërmarrja) .....

   .....
4. Refuzon formimin profesional falas: ..... ☐

   Përshkrimi i formimit/kursit të ofruar.....

   .....

Arsyeja e mospranimit: .....

.....

Punëkërkuesi

Specialisti

(emër, mbiemër, nënshkrim) (emër, mbiemër, nënshkrim)